Shtojca 2 :

Raporti i vendimmarrjes së Komisionit të Përhershëm

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS
KËSHILLI BASHKIAK

Komisoni i Përhershëm për Ekonomine dhe Kontrollin e brendshem financiar

RAPORT VENDIMMARRJE

Nr. 23 datë 23/ 10/ 2025

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lënda: Për miratimin e Planit Strategjik të Zhvillimit të Bashkisë Has 2026–2030

BAZA LIGJORE Komisioni i Ekonomisë, Financave, Pasurisë dhe Zhvillimit, në mbështetje të:

Neneve 54 dhe 55 të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore";

Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 353, datë 11.05.2016, "Për përgatitjen dhe zbatimin e planeve strategjike vendore të zhvillimit të njësive të vetëqeverisjes vendore";

Udhëzimit të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 24, datë 29.09.2021, për procesin e planifikimit dhe programimit buxhetor;

Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2021–2030;

Si dhe në përputhje me kompetencat funksionale të Këshillit Bashkiak Has, për miratimin e dokumenteve strategjike vendore,

shqyrtoi materialin e përgatitur nga Bashkia Has mbi Planin Strategjik të Zhvillimit 2026–2030 dhe Relacionin shoqërues të Kryetarit të Bashkisë.

DISKUTIMI DHE VLERËSIMI I KOMISIONIT Pas shqyrtimit të dokumentit dhe materialeve mbështetëse, Komisioni vëren se:

Plani Strategjik 2026–2030 përmban një analizë të plotë të situatës aktuale, objektiva të matshme dhe një kornizë financiare orientuese;

Procesi është zhvilluar në përputhje me parimet e pjesëmarrjes, transparencës dhe bashkërendimit ndërinstitucional;

Dokumenti garanton koherencë me prioritetet kombëtare dhe rajonale të zhvillimit, veçanërisht me Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit dhe Integrimit dhe me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Has;

Komisioni vlerëson se ky plan përbën një udhërrëfyes të rëndësishëm për vendimmarrjen lokale, buxhetimin afatmesëm dhe bashkëpunimin me donatorët ndërkombëtarë.

VENDIMMARRJA Pas shqyrtimit të materialit dhe diskutimeve të zhvilluara, Komisioni i Ekonomisë, Financave, Pasurisë dhe Zhvillimit, me votim unanim,

VENDOSI:

Të miratojë Planin Strategjik të Zhvillimit të Bashkisë Has për periudhën 2026–2030, si dokumentin bazë të politikave zhvillimore të Bashkisë;

T'i propozojë Këshillit Bashkiak Has miratimin përfundimtar të këtij dokumenti strategjik në mbledhjen e ardhshme;

Të ngarkohet Kryetari i Bashkisë Has për zbatimin, ndjekjen dhe raportimin periodik të zbatimit të Planit Strategjik, në përputhje me kornizën afatmesme buxhetore dhe planin vjetor të investimeve;

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas miratimit dhe i bashkëlidhet materialit që i paraqitet Këshillit Bashkiak për miratim.

KRYETARI I KOMISIONIT

Amindo Tegjoti

Shkëqim Myzyraj

Fatjon Moring